REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KOORDINATORI I KONSULTIMIT PUBLIK

Maliq, më 14 . 11 . 2025

Listë prezenca në dëgjesën publike PBA 2028, Buxheti 2026, Paketa fiskale 2026.

Nr.	Emër Mbiemër	Profili	Fshati	Nënshkrimi
1	Foski Zhuli	Z.V. kryetari	Libonik	[signature]
2	Roxhena Zgorani	Kryetar fshati Pocestë	Pocestë	[signature]
3	Mojat Fosho	Kryetar fshati Kokac	Kokac	[signature]
4	Syrya Hamzallari	Kry i F. Velitër	Velitërai	[signature]
5	Maksim Mupllai	Kry. Nokoshi	Nokoshi	[signature]
6	Sokol Kallea	Kryeplak	Zboy	[signature]
7	Rudina Brepu	Administrator Libonik	Libonik	[signature]
8	Arnela Boja	S. Mjedisi	Shegeras	[signature]
9	ERA BEZATI	Koordinatore Projekti	B.Maliq	[signature]
10	Dajana Kolami	S. Higjene	B. Maliq	[signature]
11	Bianka Mulla	S. Shendetësie	B. Maliq	[signature]
12	Joana Hoxha	P. Sektori	B. Maliq	[signature]
13	Klaudia Hersinllari	P. Sh. Social	Hj. A. Gorë	[signature]

	Arben Zosellari	Kryeplak	Pirg	[signature]
	Thanos Kojo	Kryeex.	[signature]	
	Petrika Mata	Pol. Bosh.	Boshice	[signature]
	Ilmeshik Ma	P. Mehmili	Boshkovi	[signature]
	Edmond Arsulari	Kryeplak	Sylmar	[signature]
	Amarildo Gela	Ekonomist Tatoke	Maglicë	[signature]
	VASIL TALKA	Kryetar F. Shk	LIBOWIK	[signature]
	Jurgen Ysufllari	B. Malig.	(Ulacist)	[signature]
	Florenc Muçollari	Pergj. Arsim e Shendeti	Symiz	[signature]
	Enea Cybri	KUJDHF	Malig	[signature]
	Andi Sulo	DPA	Jurist	[signature]
	Stifan Belishtei	E. civile	P/sektor.	[signature]
	Myzafer Hasmillari	Kryeplak.	Kryeplak	[signature]
	Andrea Borjamllari			[signature]
	Andrea Baxheli	K/Plak	Xreshtas	[signature]
	Matilda Shoholli	Pergj buxleti	Malig	[signature]
	Almira Muha	Dr. finance	Malig	[signature]
	Jonila Xhidli	Sek. i Pergj	Malig	[signature]
	Gerilda Prapo	Nep. finance	Malig	[signature]
	Jona Grabocka	Dr. to Andhrat	Malig	[signature]
	Arnoldi Amellari	Kryetar KB	Malig	[signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KOORDINATORI I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr._____Prot. Maliq, më 14. 11. 2025

INFORMACION RRETH NJOFTIMIT

Njoftimi për organizimin e konsultimit publik për projekt-dokumentit të rishikuar të PBA-së për vitet 2026-2028 dhe buxhetin e vitit 2026 u bë më datë 14.11.2025, njoftimi me u publikua në faqen web të Bashkisë Maliq, (si dhe në faqet e facebook të bashkisë Maliq (https://www.facebook.com/profile.php?id=100064823829762) dhe Këshillit Bashkiak. Po ashtu njoftimi u është dërguar njësive adimistrative dhe kryetarëve të fshatrave.

KONSULTIMI PUBLIK

Duke u bazuar në ligjin nr. ligjin nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", i cili ndër të tjera ka për qëllim nxitjen dhe sigurimin nga autoritetet lokale, pjesëmarrjen e qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara të politikëbërjes dhe vendimmarrjes në nivel lokal, duke ndikuar kështu në zhvillimin e politikave të qëndrueshëm në interes të përgjithshëm. Bashkia Maliq, në bashkëpunim me njësitë administrative, si dhe me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave mbajtën konsultim publik për projekt-dokumentin e rishikuar të PBA-së, për vitet 2026-2028 si dhe konsultim publik për buxhetin e vitit 2026.

Më poshtë janë të paraqitur procesverbalet e mbajtura në çdo njësi sipas problematikave që u hasën.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 14.11.2025, ora 11:00, në Sallën e këshillit Bashkiak Maliq ku u zhvillua dëgjesa publike me temë "*Projekt-buxheti i vitit 2026-2028 dhe buxheti i vitit 2026si dhe paketa fiskale 2026*".

Konsultimin e kryesuan:

- Kryetari i bashkisë, z.Gëzim Topçiu;
- Kryetari I këshillit , Z.Ornild Demollari
- Kryetari I komisionit te financave pran këshillit,Z.Petrit Kupe
- Të pranishëmn Këshilltar , kryetar Fshatrash, Qytetar , Administrator

Kryetari I Këshillit : Mirë fillojmë neve, duhet të presim edhe disa të tjerë akoma, po fillojmë ndërkoha dhe pastaj kur të. Mirëdita të gjithëve dhe faleminderit që keni erdhur që u përgjigjet thirrjes për këtë takim. Ky është një takim që organizohet nga Këshilli i Bashkisë për konsultime. Është takim konsultativ. Dhe bëhet për buxhetin, për buxhetin e vitit dy mijë e njëzet e gjashtë, buxhetin dhe paketën fiskale. Vjen si detyrim ligjor që e ka këshilli në bashkëpunim me ekzekutivin. Po dhe si detyrim moral, se kjo detyrim ligjor, detyrim ligjor edhe si detyrim moral që. Të konsultohemi me komunitetin përpara se të finalizohet buxheti për vitin e ardhshëm. Ky është qëllimi i takimit. Ju besoj se është hera e parë që kemi zhvilluar takime të tilla. Ekzekutivi kryetari do të japë prioritetet, pastaj ju do të jepni mendimet për zonat respektive. Kemi njoftuar kryetarët e fshatrave, disa kanë erdhur, disa mbase vijnë tani në vazhdim, po ne vijojmë. Petriti është kryetari i komisionit të financës në Këshillin e Bashkisë, prandaj është me ne. Kjo është kryetar, mund të na thuash prioritetet që keni ose?

Kryetari I Bashkisë : Mirëdita të gjithëve. Siç e tha kryetari i këshillit, ky është një takim i organizuar ose i kërkuar nga këshilli bashkiak. Ne si organ ekzekutiv kemi realizuar pothuajse dëgjesat në çdo njësi administrative. Me kryetar fshati, me administratorë, me persona që kanë interes nga ajo. Për këtë kanë interes të gjithë, gjithë komuniteti, por kemi patur prezencë edhe të anëtarëve të këshillit të forcave të ndryshme politike dhe kjo është pozitive. Ju munduar të marrim të gjithë problematikat në takimet që ne kemi bërë bashkë me Drejtorinë e Financës. Kemi bërë një database të të gjithë. Asaj çfarë kanë ngritur, jo se nuk i dimë, por në një farë mënyre jemi munduar që të marrim një farë prioriteti. Çfarë prioriteti numër një ka çdo fshat, themi aty hallet. Nga njëri fshat në tjetrin dyshojnë, asnjëherë s'mbarojnë hallet, se edhe bashkia është si një shtëpi e madhe. Që sa mbyll një pikë, hapet një pikë tjetër, por këtë. Ne jemi munduar të të precizojmë dhe kemi hedhur në letër pothuajse çdo gjë, për çdo fshat, për çdo njësi, për çdo gjë që na ka dalë në dëgjese. Të njëjtën kohë kemi kërkuar edhe nga kryetarët e fshatrave, respektivë, që edhe ata. Në autoritetin që kanë drejtuesit të një fshati, të kryetarit të fshatit, të bëjnë dhe ata një njoftim, një shkresë, një. Dy gisht letër, duke na njoftuar për atë çfarë ata mendojnë që mund të jetë prioritet. Po ecim në këtë linjë, sapo na kanë ardhur edhe shifrat e projektbuxhetit nga qeveria për. Për atë buxhetin dy mijë e njëzet e gjashtë ka një rritje fondi në masën rreth gati nëntë pikë shtatë dhjetë për qind në totalin e përgjithshëm të hyjnë të gjitha. Që nga pritja e pagave, nga paga minimale, hajdeni përpara, hajdeni. Ëh, prioriteti ende tek ne, ose vazhdon të jetë.

Prioritet pothuajse në të gjithë fshatrat, nga ato që na kërkojnë, ngelen infrastruktura, ngelen rrugët. Tashmë. Nuk ka më të kërkojnë rrugë kryesore, se rrugë kryesore pothuajse në të gjithë. Në të gjithë qendrën, zonën, më mirë o kini ndonjë orar, as kini edhe sa korrekte. Që këtu duket si mund të ecin edhe sa mund të ecin puna kur s'jemi korrekt me njëri-tjetrin. Në zonën e fushës, Koli do ulesh o Koli. Pothuajse janë të lidhur me rrugë me asfalt të gjitha fshat. Jo vetëm kaq, por në çdo fshat kemi asfaltuar një, dy, tre, katër, pesë rrugë e lagje. Edhe ne me punën tonë mundohemi që të shkojmë sa më afër shqetësimeve të njerëzve, sa më afër problematikave që ata kanë, por asnjëherë nuk mbarojnë. Për të qënë të sinqertë, gjithë infrastruktura dhe ne kemi bërë një prioritet edhe pas propozimeve që kanë bërë vetë banorët komunitetet për atë çfarë dije. Unë kam qenë bashkë me grupin e inxhinierëve në terren. Dhe kam filluar të të çoj grupin e

kam qenë bashkë me grupin e inxhinierëve në terren. Dhe kam filluar të të çoj grupin e inxhinierëve teknik të Drejtorisë së Planifikimit të Territorit. Në të gjitha rrugët të cilat janë propozuar në përgjegjësat publike që ne kemi bërë. Dhe paralelisht me të ecim pastaj sipas zonave, pasi në një zonë ka probleme të tjera në një fshat. Po ashtu, infrastruktura rrugore. Do të ecim me atë ritëm, ende ne nuk kemi bërë një, nuk kemi bërë një detajim të fondeve për dy mijë e njëzet e gjashtën. Pasi bëjmë gjithë shpërndarjen e fondeve sipas parashikimeve që ne kemi, edhe sipas prioriteteve që kemi në çdo zë, në çdo. Program buxhetor dhe pastaj një pjesë të saj që është e konsiderueshme është edhe patjetër fondi për investime, i cili është më i prekshëm ndonjëherë. Prioriteti i dytë ka të bëjë me ujin e pijshëm, i cili, edhe pse ka përmirësim në zona të caktuara, ende ngelet problem në disa zona. Dhe ne kemi kërkuar, edhe pse nuk e mbulojmë me tani, është drejtori rajonale në Korçë, por financimet ndodhin nga buxheti i shtetit. Po luftojmë që të kemi një ujësjellës rajonal për zonën e pirgut, i cili do të përmbushë gjithë problematikat që ka kjo njësi. Edhe pse aty po investohet për momentin në pirg, do të investohet shumë shpejt në sovjan. Po kemi probleme në zvirinë, nuk kemi ujësjellës fare. Ashtu ka qenë mënyra e organizimit prej kohësh dhe aty s'ka një rrjetë ujësjellësi. Dhe po synojmë të kemi një një ujësjellës që të përmbushi të gjitha nevojat e kësaj njësie. Vreshtasit është përmbyllur ujësjellësi i Podgoricës, ku tashmë kemi ujë njëzet e katër orë. Bregasi ka ujë njëzet e katër orë. Sheqerasi ka një përmirësim të ujit të pijshëm. Ngelemi problem vetëm në vreshtas, për të cilën shumë shpejt do të rehabilitohet depoja e asaj e atij fshati nga yjësjellësi. Dhe të shpresojmë që edhe aty të shkojmë mu njëzet e katër orë, edhe nga burimet që janë rreth e rrotull apo dhe me ndonjë shpim të ri në Pojan. Sot që flasim, po mbyllet ujësjellësi i zvezdës. Do të kemi një shpim shumë shpejt për një depo në zemlak. Edhe pothuajse gjithë zona e Pojanit është e stabilizuar me ujë të pijshëm, përjashtuar pastaj momentet e caktuara të cilat mund të jenë nga rënia e burimeve apo probleme teknike që mund të ketë. Në rrjetë apo mungesë energjie elektrike që i kemi gjithandej pas saj, liboniku në një farë mënyre ka. Ujë me probleme të veçanta që mund të kenë zonat që mund të jetë Kloca, Symizi. Kemi bërë një investim në zonën e Tylbes Goçës, të cilën themi se do ta përmirësojmë në atë zonë. Është shumë i zi. S'ka përmirësim, por jo ashtu siç duhet. Kështu që po shikohet nga rajoni, nga drejtoria rajonale, e cila tashmë është edhe aksionere në një farë mënyre e plotë. E ka marrë shteti, jo ne ne jemi mbushës, për të realizuar, për të përmirësuar furnizimin me ujë të pijshëm në të gjithë territorin e bashkisë. Infrastruktura e shkollave. E qendave shëndetësore ka një përmirësim. Ne po synojmë tashmë për ta ngritur nivelin e projekteve tona. Kemi bërë projekte të re për shkollën e mesme dhe nëntëvjeçare të qytetit Maliqit, pasi nuk kanë palestra. Kemi bërë një projekt të ri për shkollën e Sheqerasit, sepse edhe ajo është një shkollë që ka nevojë për një palestër. Po marr shkollat e mesme më shumë, të cilat e ka detyrim edhe Ministria e Arsimit për t'i patur me palestra të mbyllura. Kemi ndërhyrë në shkollën e Pojanit. Tashi kemi një shkollë të mirë të mesme në shkollën e pirgut me një palestër të re. Projekti që kemi futur për arsimin është edhe Shkolla e Zvirinës dhe Shkolla e Fshat Maliqit, të cilat kanë nevojë për rikonstruksion. Qana shëndetësore kemi ndërhyrë me gjysmë hënën e kuqe, e kemi bërë deri tani. Na janë dhuruar tetë investime, tetë qendra shëndetësore. Ata janë të prirur për të investuar edhe në qendra të tjera. Ngelen tre qendra, të cilat janë më të mëdha se sa ato që bëhen këta tip të vogla, që është qendra shëndetësore e Vloçishtit, qendra shëndetësore e Ormanit dhe qendra shëndetësore e Zëmblakut. Të cilat shpresojmë që do të jenë pjesë e investimeve të dy mijë e njëzet e gjashtës nga Ministria e Shëndetësisë. Ujitja dhe kullimi është një problematikë shumë e madhe. Edhe për bashkinë tonë, edhe pse kullimin e kemi vënë përpara dhe nuk kemi me përmbytje, edhe për falë të punës që ne kemi bërë, por ndoshta ndonjëherë edhe për rreshjet që në një farë mënyre kanë rend disi. E dyta

për në fushën e ujitjes, edhe pse kemi bërë investime të konsiderueshme në kolektorët kryesorë, në linjat kryesore Vërçunë, Podgorije, Podgorije Sovjanë. Stacion pompimi në Vreshta, stacion pompimi në Pojan, rehabilitim ndika e zënë blakut. goxha investime. Ne po synojmë për disa projekte të tjera dhe jemi duke kërkuar financim për një stacion pompimi në Ura e Maliqit. Që do bëjë të mundur përmirësimin me ujë të zonës nga Maliqi deri në drejtim të Sovjanit, edhe të pirgut. Jemi duke mbyllur një projekt për sistem vaditje me pika në leminot pirg, për të bërë të mundur që rezervuari i leminotit të mos vaditë me përmbytje. Por të vaditet është një projekt pilot që mendojmë të realizojmë me Ministrinë e Bujqësisë. Na është kërkuar prej tyre. Mund të jetë projekt pilot në rang vendi për të shikuar cili do jetë efektiviteti i ujit. Dhe do të rehabilitojmë edhe dy ushqyes, një të ushqyes të lëminotit dhe një të kloçës. Për të bërë të mundur përmirësimin e rezervuarve që kemi në këto zona, është një projekt për rehabilitimin e digës së Kolanecit. Ajo është më shumë në kuadrin e garancisë së digave, për të cilën po kërkojmë, dhe aty të ketë një ndërhyrje. Në lidhje me problemet e kanalizimeve të ujërave të zeza, duhet të jemi të kujdesshëm. Nuk na lejojnë shumë për të bërë këtë projekt pa patur kolektor të trajtimit të ujërave të zeza dhe ky është problem. Po punoj me Ambasadën Sllovene për një investim për qytetin e Maliqit dhe për Libonikun, për të ndërtuar një impiant të trajtimit të ujërave të zeza. Na ka mbetur pa mbyllur një pjesë e ujërave të zeza në bregas, një pjesë në burimas, një pjesë në zmblak. Një pjesë në Vloçisht, të cilat do i përfshijnë në një projekt të përbashkët për t'i mbyllur. Disa mund të kem harruar në një, por këto janë ato. Kryesoret për të cilat ne po i mendojmë t'i parashikojmë në buxhetin e dy mijë e njëzet e gjashtës. Probleme të vogla s'dua të merrem me probleme të vogla, të cilat mund të jenë. Ndriçimet rrugore, çaklli nëpër rrugët e parcelave, të cilat do të ketë një shtim fondi në zonën malore të Gorës dhe të Moglicës. Po parashikojmë të dyfishojmë fondin për. Rehabilitimin e rrugëve në zona të vështira për betonimin e kthesave, të cilat janë problem. Për efekt të asfaltimit, nuk dua të ndryj rruga iks e rruga ypsilon, se do hap një avaz shumë të madh. Biles, ne edhe në këshillën e bashkisë. Se kështu e ka parashikuar edhe qeveria dhe ligji, që këshilli miraton nivel programi dhe ne pastaj detajohemi në objekte. Dhe mundohemi që fondet që i tenderojmë, i kursejmë, i tenderojmë dy herë, që të kemi mundësi që të bëjmë sa më shumë rrugë me të njëjtat para, të cilat janë të programuar sipas zërave përkatëse. Kemi ndërhyrë në rehabilitim godinash ndërtimore, siç janë pallatet, çatitë. Shumë punë është bërë në Drithas, Libonikë apo në zona të tjera sheqeras. Por kjo është vetëm fazë e parë, po mundohemi që të kemi një fazë të dytë në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, për të bërë të mundur të gjithë sistemin. Po mbyllni ato telefona, kush i ka? Sistemi ka po të pallateve dhe revolucionet e çative, por dua të bëj një apel për ju, por dhe për ata që na dëgjojnë, që duhet të fillojnë ta ndryshojnë. trendin do deshëm një bashkëfinancim projektesh nga vetë banorët, që ne t'i mbulojmë dhe ta realizojmë ndoshta në një kohë më të parë se të tjerat. Kur kemi një bashkëfinancim, një kontribut të vetë komuniteteve, ne jemi të prirur ta vëmë në radhë të parë si prioritet. Fushën e kulturës, të arsimit, sportit, po mundojmë. Pallati i kulturës po bëhet Maliq. Besoj do jetë një nga më të mirët në Shqipëri. Do të mundohemi të rehabilitojmë edhe disa qendra të tjera që kanë të bëjnë, kanë qenë ish-kinemat, siç e ka Vreshtasi, e ka Vloçishti, ka një zëmblaku. Ka një kemi një qendër, një të tillë në të robë, të cilat mund të shërbejnë edhe për për trajtim të moshave të vjetra, apo si qendra të cilat u shërbejnë moshave të treta. E kemi rritur këtë ambientet për moshat e treta dhe mendojmë do ta shtojmë nga zonat më të populluara edhe të. Pasi edhe ato kërkojnë fonde, kërkojnë financime, si nga ministria, si nga nga ne, si nga qarku. Po do të mundohemi ta rrisim në varësi edhe të ambienteve apo të kërkesave që do të kemi. Nuk e dija, i thashë të gjitha, se telegrafisht i mora kështu, siç, siç unë i radhit. Nuk do të hyja, por ndoshta kjo është pjesë që mund të dëgjoj. Edhe ndonjë problematikë

që mund ta kem harruar për t'i dhënë ndonjë përgjigje të shpejtë, jemi drejt hartimit të projektit të buxhetit. Apeli duhet të jetë që duhet të paguajë me më shumë taksa. Debitorët, ne të. I mbajmë në librat tonë dhe secili ngelet aty në momentin që ju kërkoni të kryeni një shërbim bashki. Ajo u del si debitim ndër vite. Mirë është ta paguani çdo vit atë pak taksë, pasi ne i kemi ndoshta taksat më të ulta në gjithë Shqipërinë. E kemi ulur tridhjetë për qind të gjitha llojet e taksave, por kur i paguan pjesë-pjesë, nuk duken shumë. Kur i paguan njëherësh disa vjet, ato vërtetë duken shumë. Kemi filluar, kemi marrë një vendim këshilli që mbledhja e taksave dhe tarifave të bëhet me agjent tatimor, siç është ujësjellësi. Do të fillojmë nga Maliqi, po besoj do ta shtrijmë të gjithë bashkinë, që në faturën e ujit t'u vijë edhe pagesa e taksave, e ndarë në muaj, që të mos iu duket edhe shumë. Edhe pse sasia është e vogël, mund të ketë nga ata që paguajnë njëherësh. Kjo s'ka asnjë problem. Shumë faleminderit, unë kaq kisha. Jam i prirur të dëgjoj ndonjë shqetësim, ndonjë mendim.

Kryetari i këshillit: Petrit do të kishin gjë apo pak a shumë do të dëgjojmë nga pjesa që është thirrur. Janë dhe kryetarët e fshatës, domethënë ata dhe i këshilli. Këtu është dhe qëllimi i takimit. Kështu që mendoj të presim dhe të dëgjojmë ata, megjithëse secili pastaj të shfaqë këto mendime vetje.

Kryetar i keshillit : Tani presim mendimet.

Faslli Zholi: Përshëndetje, jam Faslli Zholi, anëtar i Këshillit të Bashkisë së Maliqit. Përshëndetje të zgjedhur, përshëndetje kryetar, përshëndetje të gjithë pjesëmarrësit në këtë takim. Bëhet shumë mirë që ne diskutojmë për paketën fiskale të vitit 2006. Dhe në lidhje të bashkisë tonë, bashkia unë e konsideroj si një familje. E secilit, po kjo është një familje e madhe që bëjnë pjesë të gjithë komuniteti i bashkisë tonë dhe prioritetet i shpalosi edhe kryetari. Unë në radhë të parë duhet ta falenderoj punën që është bërë deri tani në bashki dhe kryetarin, të cilin. Ka bërë për mua shumë punë në rrugën, siç tha edhe rrugët kryesore në infrastrukturë. Po nuk duhet të vetëkënaqemi as vetë ekzekutivi, edhe ne si anëtarë këshilli, po dhe vetë qytetarët kanë kërkesa më shumë në këtë situata, sepse. Është një punë e një fëmije sa më lart të bëhem hallet dhe problemet, kërkesat janë më të mëdha. Unë do të shtroja disa gjëra që mendoj këtu për këtë buxhet. Unë i kam ndjekur dhe dëgjezat nëpër fshatet mbas njësive ndore. Kam qenë prezent, i kam dëgjuar edhe. Një vërejtje e kam sot për pjesëmarrjen, që pjesëmarrja nuk është e këndshme. Aq më tepër, edhe kryepleqtë duhet të jenë këtu, sepse përfaqësojnë fshatrat, përfaqësojnë komunitetin. Të cilët duhet ta dëgjojnë dhe duhet t'japin mendime që neve të kemi kontakte për t'i zgjidhur ato probleme që ka komuniteti. Duhet të ishte më pjesëmarrje me mall. Një problem që desha të trajtoja, bashkia e Maliqit kuptohet që është një bashki në pozicion, qoftë edhe gjeografik strategjik, që është e mbështetur gjithmonë në bujqësi. Edhe bujqësia për mua është prioriteti kryesor, sepse aty ka edhe punësimi individual apo familjar i qytetarëve që jetojnë nëpër fshatrat e njësisë së bashkive tona. Desha të thoshja që përsa i përket kullimeve të është bërë një punë e mirë. E tha dhe kryetari që janë bërë kanalizimet, janë bërë po merren masa edhe për vaditjet. Dhe kemi shkuar te në atë pikë që edhe lidhja e parcelave ka filluar dhe çakullosja ato. Mirë është që të shtohet pak fund, që të jenë parcelat të lidhura. Që të hyhet me mjetet për të vënë atë prodhim që kanë bërë, po një pikë kryesore që mendoj unë duhet të diskutojë, dhe dikasteri kryesor. përsa i përket shitjes të prodhimeve, sepse prodhimet bëhen. prodhohen, por në këtë takim duhet t'u bëjë thirrje të gjithë fermerëve që edhe të sigurojnë parcelat. Që t'i paraprijmë se ne kemi diskutuar në mbledhjet e këshillit për fatkeqësitë natyrore, për shembull në ngricët që diskutuam dhe u dëmtuan. Frutat u dëmtuan, gjithë qershitë u dëmtuan, por janë dhe disa rregulla që duhet t'i kuptoj secili gjë. Në qoftë se ne nuk e sigurojmë, qoftë edhe

parcelën. Qoftë edhe ato pemëtarinë e të gjitha gjërat, që edhe pastaj të marri dhe shpërblimin, sepse në kapitalizëm dhe në këtë sistem është që më jep që të të jap. Përsa i përket taksave, unë jam plotësisht dakord edhe me kryetarin që edhe duhet të jemi një çik më të kujdesur në taksat. Ne e vërteta është ajo që taksat i kemi patur edhe më të ulta. Por duke parë dhe fukarallëkun që ka dhe zona, se kuptohet që e thashë që ne jemi me bujqësi dhe ato pak prodhime nuk shiten dhe nuk kanë shkuar ashtu siç. prodhon dhe nuk merr atë mundimin që kanë secili fshat apo secili familje. Një problem tjetër që mendoj unë për bashkinë e Maliqit duhet parë në çik përsa i përket arsimimit, sepse që të bësh punë do të kesh edhe njerëz dhe kontingjentë. Të pregatitur dhe në arsimim, e flas këtu dhe që të filloj që me arsimimin parashkollor. Me kopshtet, me çerdhet, është bërë një punë e mirë. Mendoj se ka vend, ne ishim edhe në një dëgjesë për një problem në një fshat. Atje ishte një shkollë. Pavarësisht se ishin dy fëmijë, po nuk kishte as karrige, as tavolinë. Kemi qenë së bashku bashkë me kryetarin. Dhe ka mundësi që aty të shikohet. Kjo ishte në B. Velça, po kështu ka dhe zona të thella, të cilat unë nuk them që të bëhet diçka, qoftë edhe në Moglicë, qoftë edhe në Gorë, apo edhe të gjetur në fshata të thella. Që të bëhet një investim i madh kur nuk ka fëmijë, po investimi më i madh mendoj që të përqëndrohet aty ku janë fëmijët që janë edhe baza, po pa e përjashtuar edhe ata që janë sa më pak fëmijë, sepse të Në fund fare të drejtat i kanë një lloj si ajo që është tre dhe ajo që është dhjetë veta. Një problem tjetër desha të ngrija këtu në këto dëgjesa për mua është edhe përsa i përket ndihmave që u vjen bashkia në ndihmë familjeve në nevojë. Këtu duhet patur kujdes, sepse ne kemi edhe raste të hidhura, siç ishte edhe familja e të ndjerëve të tre pjesëtarëve të një familje. Dy fëmijë dhe nëna e vet, pavarësisht nga ajo, po ata ikën në mënyrë tragjike. A ishte faji i bashkisë apo i, nuk e them këtë, po për t'i paraprirë këto. Duhet patur kujdes edhe në investim dhe duke u qëndruar dhe duke evidentuar mirë këto situata të tilla, të cilat mos na ndodhin më, aq më tepër në qytetin apo në bashkinë tonë. Përsa i përket shëndetësisë, mirë tha kryetari, janë edhe ato tre qendra, ne i dimë edhe janë bërë shumë qendra shëndetësore. Unë e ngrita disa herë qendrën e Libonikut, u bë aq sa u bë, dhe desha kërkova që të shtohesha ajo pjesa aty. Më tha që është ai vendi, sepse atje është një vend i ngushtë dhe fshati është i madh. Ajo është shumë vend i ngushtë. Unë edhe dje kam qenë vazhdimisht. Njerëzit nuk kanë ku këmbehen brenda që të bëjnë një vizitë apo të bëjnë një matje tensioni. Duhet që ajo bananga që është atje, e kam thënë edhe në këshillë, që mundësisht të bashkohet, qoftë se mos dhe ta ketë derën, siç e për të hapur një hapësirë, sepse është fshati më i madh. Një diçka tjetër do të them në lidhje me Libonikun. E kam ngritur edhe në këshillë dhe po e them edhe këtu. Nuk e di ashtu se kryeplaku mundësisht të vihet në prioritet. Varrezat e Libonikut janë rruga është e vërtetë. Dhe ujin atje nuk ka, e kam thënë, dhe ashtu prandaj duhet parë kjo me përparësi. Se varrezat e Libonikut nuk janë në një gjatësi apo në një kilometrash i madh. Ka mundësi kryetar që të shtrohet ajo, të mbyllet ajo. Nuk flas pastaj rrugët brenda janë bërë, a ka vend ka për përmirësim. Po rrugët që e mban me dritha, se me këto, është për të falenderuar bashkia dhe juve. Po varrezat duhet të bëhen, kur them për këto. Ne kemi edhe pjesë të varrezës të tjerë që mund të ketë edhe më keq, po më keq se në Libonik besoj se nuk ka unë me aq sa di unë. Sepse nuk ka dhe ujë, gjynah të mos ketë ujë aty. Të ndodhin nëse jemi të gjallë dhe kemi lidhje të vdesim, duke ju falenderuar të gjithëve. Për këtë takim, ju uroj suksesa dhe punë të mbarë.

Kryetari I Këshillit :: Faleminderit, po.

Pranvera Begolli: Mirëdita, përshëndetje të gjithëve. Faleminderit për këtë takim që po zhvilloni. Do të gjesh publika, e cila është në të mirë të komunitetit. Nuk dëshiroja që të kishte

më shumë përfaqësi edhe nga këshilltarët, siç tha edhe bashkëfolësi, përveç kryepleqve. Ah, e dëgjova programin që tha kryetari. Jemi gjithmonë prezent kur miratojmë buxhetin si anëtare e Këshillit Bashkiak. Ju falenderoj për punimet e mira që janë bërë në qytetin e Maliqit. I është ndërruar fytyra e qytetit tonë. Ka marrë një, një, një, fytyrë harmonike që je qejf ta shikosh, por unë do ngrija disa probleme që mendoj se mund të preken në buxhet. Te varrezat e qytetit, aktualisht brenda varrezave janë dëmtuar shumë rrugët e brendshme. Do desha të merresha parasysh një investim. për t'u vënë me pllaka a diçka tjetër, rrugët e brendshme të varrezave në qytetin tonë. E mira do ishte që në qytetin e Maliqit të kishte një kënd sportiv. Ndoshta është diskutuar gjithmonë për tek gropa e brezive apo kudo, për të rinjtë dhe për fëmijët, sepse stadiumi është vetëm për. Futbollin nuk është për lojëra të tjera, palestra edhe kjo e shkollës së tetëvjeçare mbyllet, shkolla nuk shkojnë. Gjithashtu, dhe kënde lojrash për fëmijët, sepse është vetëm një kënd lojrash tek lulishtja. Atje tek kopshti mbaron, kopshti mbyllet, nuk të lejon roja të vijnë më fëmijët, dhe fëmijët nuk kanë ku arkëtohen dhe ku vijnë ku t'i çojnë. Prindërit janë detyruar të shkojnë në një lokal, t'i mbyllin atje të lozit, ku është më mirë të kenë hapësira publike. Gjithashtu, do desha kryetar, siç e kemi parashikuar çdo vit, të mbetet përsëri në buxhet në ndihmë të vajzave dhe grave. Që hapin biznese për herë të parë, ne e kemi patur gjithmonë, po do të ishte edhe vazhdimësi që të paktën të përjashtojnë gjashtë muaj nga taksat. Për ato që hapin një biznes për herë të parë, për t'i ndihmuar për të qënë në këtë. në në ndihmë të tyre, ju e prekët kryetar dhe për punën e pallateve. Ju falenderoj për atë çka është bërë, por tek pjesa jonë ka pallate që akoma Janë të viteve shtatëdhjetë e tre, shtatëdhjetë e dy, që kanë nevojë edhe ndoshta edhe për një vesh e kapot, por edhe për çatitë që janë më emergjente. Gjithashtu, e di që kryetari do të thotë të fletë për bllokun numër tre. Unë flas për gjithë qytetin, meqënëse jam këshilltare e kësaj zone. Ka mbetur një pjesë e asfaltuar te pjesa larg, ku kanë erdhur këta të bickës. A mendohet për vitin dy mijë e njëzet e gjashtë të bëhet asfaltimi i asaj pjese? Ju faleminderit dhe punë të mbarë për të gjithë.

Petrit Kupe: Ti vera je dhe këshilltare e Kolanecit. S'të gjë për Kolanec.

Pranvera Begolli : Kolaneci është parashikuar. E zgjoi kryetarin që thotë që rruga do asfaltohet, do bëhet nga Fondi i Zhvillimit. Ka bërë punime në Kolanec.

